



KOMUNA E KLINËS  
KUVENDI I KOMUNËS  
01. NR. 06-2576  
KLINË, MË 20.3.2017

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I SEANCËS SË III-të TË KPF, MBAJTUR, MË 20.3.2017, NË ORËN 10.00,  
NË SALLËN E KK

Në mbledhje prezantuan: Kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, drejtorë të drejtorive, OSBE, Zyra ligjore, OJQ "Koha", mediet etj.

Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në këtë seancë të KPF-së.

Në vijim kryesuesi Ibishi prezantoi rendin e ditës. Hapi debatin lidhur me rendin e ditës. Nuk pati debate rreth rendit të ditës. Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës. Me vota unanime u miratua ky

### RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i kërkesës për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017 (Ref. Drejtoria e FEZH),
4. Shqyrtimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullore për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale,
5. Shqyrtimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës,
6. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS për mbështetje financiare të Festivalit "I këndojmë Lirisë" 2017,
7. Shqyrtimi i kërkesës së DU dhe MM për ndarje të parcelës për ndërtim të Qendrës Rinore në Klinë,
8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura në KPF janar – mars 2017.
9. Të ndryshme.

**Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.**

Kryesuesi sqaroi që nuk ka mungesa nga ana e anëtarëve të KPF-së.

**Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi e vuri në miratim procesverbalin.

**Procesverbali i seancës së kaluar u miratua me vota unanime.**

**Pika e tretë: Shqyrtimi i kërkesës për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017 (Ref. Drejtoria e FEZH).**

Kryesuesi fjalën e barti te zyrtarja e lartë e Drejtorisë së FEZH-it, Xufe Kelmendi.

**Xufe Kelmendi**, foli rreth kërkesës për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017. “Të hyrat vetanake të vitit 2015 dhe 2016 në total janë në shumën prej 328,662.55 €, të cilat i bartim për vitin 2017 dhe shpërndarja e tyre është nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, si vijon: Paga dhe mëditje 6,700.42 €; mallra dhe shërbime në shumë prej 11,355.74 €; shpenzime komunale në shumë prej 147.17 €; subvencione dhe transfere në shumë prej 12,468.18 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 297,991.04 €. Në kategorinë ekonomike, paga dhe mëditje shuma prej 6,700.42 € në programin: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730) nën-programi (74050) . Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 11,355.74 € në programet si vijon: Administrata dhe personeli (163), nën-programi (16318) shuma prej 7,182.50 €; Buxhet dhe Financa (175) nën programi (17518) shuma prej 434.81€ Arsimi dhe Shkenca (920) nën-programi (92090) shuma prej 3,738.43 €. Në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shuma prej 147.17 € në programin: Buxhet e financa (175) nën-programi (17518) . Në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shuma prej 12,468.18 € në programin: Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16018). Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shuma prej 297,991.04 € në programet si vijon: Në programin Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi (18018) në projektet : Mirëmbajtja e rrugëve , kodi (43798) shuma prej 12,425.10 €; Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimi , kodi (90065) shuma prej 6,899.78 €; Ndihmë për nevoja emergjente , kodi (88253) shuma prej 340.06 € Në programin Kadastra dhe Gjeodezia (650) nën-programi (65090) në projektin: Furnizimi me aparat gjeodezik, kodi (90072) shuma prej 15,000.00 €; Në Programin Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66395) në projektet; bashkëfinancim me donatorë) , kodi (43803) shuma prej

45,855.10 €; ndërtimi me gur i Sheshit dhe rrugëve në qytet , kodi ( 43804 ) shuma prej 187,471.00; Hartat zonale, kodi ( 43815 ) shuma prej 30,000.00 €”, ka raportuar ndër të tjera zyrtarja Kelmendi.

**Fadil Gashi**, tha se vazhdimisht kemi bërë bartje të mjeteve, mirëpo në këtë shumë është hera e parë që po bëjmë bartje. “materialet po na vijnë njëra pas tjetrës, që po na ngatërrojnë dhe nuk po jemi në gjendje t’u biem në fije. Jam kundër, sepse vetëm Guade de Finanza mezi mund t’i bie në fije. Te bartja, 2, 970.000 euro, është një projekt që është miratuar prej jush me buxhet, se ne nuk e kemi votuar, dhe tash çka është duke u bërë me te. Ky projekt vjen në një vend me një emërtim tjetër. Është mirë të sqarohet se për cilin projekt bëhet fjalë. Ne i kemi bërë bartjet e viti 1015 në 2016, çfarë dëshironi tash. Për mua është e pakuptimtë”, theksoi anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se pajtohem me konstatimet e Fadilit, që vetëm Guade de Finanze mund t’i bie në fije. “Për mua është e pakuptimtë kjo bartje e shumë. Është shumë i komplikuar dhe jam kundër se ka shumë paqartësi”, shtoi ndër të tjera anëtari Merturi.

**Ndue Shabanaj**, foli rreth çështjes tematike. “Ka pasur nevojë të sqarohemi më në detale. Këto shifra na ofrojnë më pak informacione. Sasia është e madhe, prandaj është mirë që të thuhet arsyetimi, sepse arsyetimi ia vlen më tepër se sa shifrat. Kërkoj një sqarim me detal, ta kemi më afër kuptimin për këto mbetje që janë bërë”, theksoi anëtari Shabanaj.

**Xufe Kelmendi**, sqaroi çështjet e ngritura nga anëtarët. “Çështjet janë të sqaruara, shtoi zyrtarja Kelmendi.

“Buxheti është dashur të buxhetoret. Nuk ka diçka të paqartë. Buxheti i vitit 2015 është bartur. Ka raste që nuk kemi pasur mundësi që mjetet të shfrytëzohen në tërësi, prandaj duhet shqyrtuar për këtë vit. Mbetja bartet në vitin vijues për t’u realizuar projektet e caktuara”, sqaroi zyrtarja Kelmendi.

**Fadil Gashi**, tha se po jam insistues për të qenë këtu prezent drejtori, jo që po injoroj zyrtarët e kësaj drejtorie. “Nuk jam ekonomist, edhe kuptohet që nuk i di të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë, mirëpo as Xufa nuk i di të gjitha procedurat, sepse nuk është juriste. E dimë se është bartje, i takon për të qenë rishikim i buxhetit. Nuk është emërtim i njëjtë i projektit, se di a është gur, mermer apo asfalt, në këto tri forma gjendet. Nuk ka përputhshmëri. Kemi bërë bartje prej vitit 2015. Asnjë prej tyre nuk janë të harmonizuara mes vete”, ka konstatuar anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se duhet respektuar mendimin profesional. “Zyrtarja e drejtorisë përkatëse na i sqaroi çështje, prandaj është mirë të respektohen mendimi dhe sqarimet e saj”, shtoi Kryesuesi.

**Xufë Kelmendi**, sqaroi emërtimin e projektit në shqyrtim. “Emërtimi i projektit është në rregull. Nëse një fjalë e ndryshojmë ne nuk jemi në gjendje ta bëjmë tërheqjen e mjeteve. Çdo gjë është në rregull”, shtoi zyrtarja Kelmendi.

**Ndue Shabanaj**, tha se nuk duhet pasur keqkuptim lidhur me sqarimin e kërkesës. “Unë mendoj që prania e përfaqësuesit të drejtorisë e ka për obligim që ta sqarojë atë që ne e kërkojmë. Kur të shterohen format e sqarimit atëherë ne vendosim për të votuar”, pohoi prof. Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se secili këshilltar ka të drejtën e mendimit të vet.

**Skënder Merturi**, foli rreth kontratës së projektit të sheshit. Anëtari Merturi lexoi kontratën. “Nga kjo që shkruan këtu, ka ndryshim të emrit, nuk është i njëjtë dokumenti. Emri në dokument zyrtar ndryshon, theksoi anëtari Merturi.

**Xufë Kelmendi**, sqaroi se kontratën nuk e bën Drejtorja e Financave, emërtimin e bën Zyra e prokurimit.

Kryesuesi vuri në miratim kërkesën për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017.

**Me 4 votë për, 3 kundër u miratua kërkesa për bartje të mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017.**

**Pika e katërt: Shqyrtimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullore për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.**

Kryesuesi i KK, Dr. Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. “Është mbajtur debati me publikun, ku qytetarët kanë shprehur vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e tyre, tha kryesuesi, i cili në vijim fjalën e barti te zyrtari i Drejtorisë së FEZH, z. Ajet Sejdiu.

**Ajet Sejdiu**, zyrtar i lartë në Drejtorinë e FEZH raportoi rreth ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullore për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.

“KPF-ja dhe AK-ja kanë marrë vendim që ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, të vihen në diskutim publik. “Debati me publikun është mbajtur. Hapat ligjorë janë kryer”, theksoi zyrtari Sejdiu, i cili në vijim foli rreth

ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale. Duke folur rreth ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, zyrtari Sejdiu theksoi se nenit 26 të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale të miratuar me dt.26.12.2014, i shtohen edhe 2 paragrafë dhe atë me tekstin siç vijon: “Ankesat e ushtruara kundër vendimeve lidhur me caktimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale, rishqyrtohen nga ana e organi,t i cili e ka nxjerr vendimin, sipas provave të ofruara me ankese apo edhe atyre të cilat zyrtarisht mund të nxirren nga ATK-ja, Inspektorati komunal kompetent apo edhe regjistri-evidenca adekuate e regjistrimit dhe gjendjes së obligimeve komunale të bizneseve. Paragrafi 2 i këtij neni ka këtë përmbajtje: Afati i paraqitjes së ankesave sipas paragrafit 3 të këtij neni është 8 dite nga dita e pranimit të vendimit. Neni 56 paragrafi 3 pika 1 e Rregullores, ndryshohet dhe atë sa i përket vlerës 20 €, në vend të saj caktohet vlera prej 30 €. Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 60 të Rregullores që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e Palestrës Sportive hiqen në tërësi, pasi që parashihen me rregullore të veçantë. Teksti i nenit 41 ndryshohet dhe caktohet teksti i ri siç vijon: Pagesa e taksës në emër të komunalive për objektet e përkohshme bëhet sipas U.A nr.22/2012 të dt.19.12.2012 dhe vendimit të veçante të MMPH-se, nr. 043/2013 të dt.15.03.2013 dhe kjo taksë për leje të ndërtimit është caktuar të jete 2.13 € për m<sup>2</sup>. Neni 42 pika 42.1 fshihet në tërësi dhe në vend të saj caktohet taksa për lëshimin e certifikatës së përdorimit për objekte banimi dhe afariste, caktohet taksa prej 0.10 € për m<sup>2</sup> bruto”, ka sqaruar zyrtari Sejdiu.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se mendoj që ndryshimet që janë propozuar duhet të shoqërohen me arsyetimin. “Vetëm të njëra kërkesë, neni 26, është arsyetuar, të tjerët nuk janë arsyetuar. Duhet të shohim arsyeshmërinë e ndryshimit. Është e nevojshme për të plotësuar informatën me propozim konkret. Është propozim që nuk shoqërohet me arsyeshmëri”, theksoi prof. Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në debat. “Në debatin me publikun drejtorët i kanë arsyetuar ndryshimet dhe plotësimet e propozuara, janë vetëm propozime për ndryshime”, pohoi Kryesuesi Ibishi.

**Pal Berisha**, tha se po e shoh një propozim të ri. “Në material kemi propozime të tjera. Disa propozime na kanë ardhur më herët, disa sot, të cilat nuk janë të njëjta. Cilat janë përfundimtare? E kemi të vështirë të japim mendimin rreth këtyre ndryshimeve dhe propozimeve”, theksoi anëtari Berisha.

**Fadil Gashi**, tha se është procedurë administrative 7 ditë më herët që materialet duhet të dërgohen. “Me këtë rast, është shkelje e procedurave . Materialin e gjetëm këtu, po bëni shkelje të procedurave”, theksoi anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se këtë praktikë e kam gjetur këtu. “Po pajtohem për shtatë ditshin. S’ka tendencë për asgjë”, tha Kryesuesi.

**Ajet Sejdiu**, arsyetoi nenet për ndryshim. “Me 10 janar e kemi bërë propozimin”, sqaroi zyrtari Sejdiu.

**Hajdin Morina**, drejtor i DKA-së, sqaroi kërkesën e DKA-së. Në vijim drejtori Morina arsyetoi kërkesën për ndryshimin e nenit. “Me hyrjen në objektin e ri të Çerdhes së fëmijëve, janë rritur hapësirat, që do të thotë që njëherësh janë rritur edhe shpenzimet. “Asnjë çerdhe e fëmijëve në rajon nuk ka këtë çmimin në shumën prej 20 euro. Kemi shkuar duke e marrë si parasysh edhe çmimin që kanë çerdhet e rajonit”, sqaroi ndër të tjera drejtori Morina.

**Skënder Merturi**, foli rreth çështjes tematike: “Po jap një propozim konkret: për ato familje që kanë dy fëmijë të jetë më lirë. Pajtohem me çmimin prej 30 euro. Mirëpo për dy fëmijë të një familje të jetë 50 euro, domethënë t’i bie nga 25 euro. Mendoj se kjo shumë do të ishte e arsyeshme”, shtoi anëtari Merturi.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se nuk ka askush për të ngulfatur asgjë.

**Skënder Merturi**, tha se te kapitulli i katërt (lexoi kapitullin), theksoi se edhe në debatin me publikun kam dhënë mendimin dhe po e jap edhe këtu. “Propozoj që 50 euro te zërimi, ky 50 euro të hiqet. Shfrytëzimi i sallës është 100 euro dhe në atë shumë le të jetë edhe shfrytëzimi i zërimit. Salla shkon bashkë me zorimin. Ndërsa ,sa i përket shfrytëzimit të fushës “18 Qershori”, te shuma 15 euro kompensimi të jetë për orë, unë kam propozuar që 15 euro të jetë për lojë, jo për orë. Te shfrytëzimi i fushës së futbollit 10 euro për orë, le të jetë për lojë”, theksoi Merturi.

**Ramush Agushi**, theksoi se nuk pata ndërmend të inkuadrohem, mirëpo meqenëse jam aty m’u imponua që të jap disa sqarime. “Sa i përket vlerës prej 15 euro të shfrytëzimit të stadiumit për orë, kemi shkuar në këtë shumë, sepse kjo vlerë e kompensimit është në nivel të Kosovës. Kemi shkuar në këtë formë, sepse është më lirë. Pra çmimi është në nivel regional. Jemi të harmonizuar me regjionin. Kisha propozuar që të mbetet qysh është”, theksoi anëtari Agushi.

Kryesuesi vuri në miratim për rekomandim në KK të ndryshimeve dhe plotësimeve të rregullores.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi.**

**Pika e pestë: Shqyrtimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës.**

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes. Fjalën e barti të drejtori i DKA-së, prof. Hajdin Morina.

**Hajdin Morina**, foli rreth çështjes dhe arsyetoi kërkesën për ndryshim të rregullores. Profesor Morina theksoi se kjo rregullore është rregullore për studentë të cilësisë, e jo të aspektit social apo ndonjë tjetër. “Ne respektojmë vendimin e organit kompetent”, shtoi ndër të tjera profesor Morina.

**Ndue Shabanaj**, si kryetar i komisionit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës, foli rreth kërkesës për ndryshimin e rregullores. “Vështirësitë i kemi prezantuar. Vështirësi paraqet neni 6 (sqaroi nenin 6). Në bazë të këtij nenin mund të ndajmë bursa për studentë, mirëpo të përfitojnë studentë jashtë profileve deficitare, ndërsa nuk përfitojnë studentët të profileve deficitare. Propozimi për ndryshimin e këtij neni e ka arsyeshmërinë. Kërkoj që kjo të përfilllet ose për t’u pajtuar se nuk kemi kandidatë që meritojnë bursën ose janë të pakët. Ky është pozicioni ynë. Unë si anëtar i komisionit propozoj që neni 1.5 të hiqet. Të përfitojnë studentë të profileve deficitare dhe ata me notën më të lartë. Te hiqet neni 1.5”, theksoi prof. Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se i kemi hyrë një retushimi të kësaj rregulloreje. “Kuvendi i Komunës duhet për të përkrahur iniciativën e Komisioni, tha Kryesuesi Ibishi.

**Fadil Gashi**, foli rreth çështjes tematike: “Komisionin e kemi votuar dhe e kemi ndërtuar, prandaj është absurde që konkluzionet e komisionit të mis i përfillim. Të kihet kujdes me aplikuesit e parë, sepse e drejta ligjore është në anën e tyre”, pohoi anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi për procedim në AK.**

**Pika e gjashtë: Shqyrtimi i kërkesës së DKRS për mbështetje financiare të Festivalit “I këndojmë Lirisë” 2017.**

**Haxhi Ibishi**, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Në miratimin e buxhetit për vitin 2017 për Festivalin i Këndojmë Lirisë 2017, Kuvendi i ka ndarë shumën e mjeteve në vlerë prej 20 mijë euro”, pohoi kryesuesi Dr. Ibishi, i cili në vijim lexoi kërkesën e DKRS-së.

**Fadil Gashi**, e lexoi shkresën e DKRS-së. “Sipas kësaj e paskan themeluar Këshillin organizativ. “Në po e themelojmë Këshillin organizativ, mirëpo ky këshill asnjëherë nuk

po na prezanton raport kthyes. Në bazë të kësaj, ne nuk po kemi mundësi as si shkresë, as si këshill për ta kuptuar”, tha anëtari Gashi.

**Ramush Agushi**, theksoi se kisha rekomanduar që të procedohet në KK dhe në Kuvend të sqarohet. “KK ka ndarë shumë prej 20 mijë euro, prandaj të njëjtin vendim po e miratojmë. Edhe rreth Këshillit organizativ, ky këshill zgjidhet çdo vit. Në KK kisha kërkuar sqarime”, konstatoi anëtari Agushi.

**Ajet Sejdiu**, sqaroi se Auditorët e Brendshëm dhe të jashtëm kërkojnë vendim të veçantë.

Kryesuesi Ibishi propozoi që të procedohet për në KK.

**Me vota unanime u rekomandua që të procedohet në KK.**

**Pika e shtatë: Shqyrtimi i kërkesës së DU dhe MM për ndarje të parcelës për ndërtim të Qendrës Rinore në Klinë.**

**Baki Gashi**, drejtor i DU dhe MM, sqaroi kërkesën. “të ndahen 15 ari për ndërtimin e Qendrës Rinore. “Bashkë me drejtorinë e Gjeodezisë i kemi shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me pronën. Parcela është pronë komunale, të Palestra Sportive. Komuna e Klinës ka nënshkruar një memorandum me Ministrinë e Kulturës për ndërtimin e Qendrës së Rinore”, sqaroi drejtori Gashi.

Kryesuesi hapi debatin. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim rekomandimin që kërkesa të procedohet në KK.

**Me vota unanime u miratua propozimi.**

**Pika e tetë: Shqyrtimi i kërkesave të arritura në KPF janar – mars 2017.**

Kryesuesi Dr. Ibishi, i lexoi kërkesat:

Kërkesa e Shabalatëve nga Greminiku, me përfaqësues z. Tafil Gashi, rreth shfrytëzimit të ujit të pijes të pijes nga burimi i ujit – Litica.

Kryesuesi hapi debatin.



**Fadil Gashi**, foli rreth kërkesës. “Ne vijmë nga ajo pjesë dhe i dimë gjerat. Kush ju ka ndalë ujët? Nëse është pronë private nuk mund të marrim vendim. Sa i përket lejes që ka pasur, nuk po di për atë leje, prandaj le të sqarohen gjerat”, shtoi anëtari Gashi.

**Halil Desku**, tha se lidhur me këtë kërkesë duhet pasur kujdes dhe duhet bërë zgjidhje ligjore. “Është një kërkesë që duhet trajtuar me kujdes. Kërkesa të orientohet në drejtorinë përkatëse, gjegjësisht në Shërbimin e Inspektoratit dhe ata ta vlerësojnë kërkesën dhe të japin sqarime. Pasi që është çështja e ujët të pijes kërkesa duhet të merret në konsideratë”, pohoi prof. Desku.

**Ndue Shabanaj**, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Kush e ka ndalë ujët, pse i pamundësohet shfrytëzimi? Prandaj, të adresohet në drejtorinë përkatëse, të merret inspektorati dhe ta shqyrtojnë çështjen. Të mos zhveshët KPF-ja. Drejtoritë duhet shqyrtuar dhe të na sjellën në KK për shqyrtim. Propozoj që të shkohet kështu. Le të shkojë në AK dhe atje le të vjen vendimi”, pohoi prof. Shabanaj.

**Halil Desku**, tha se edhe unë jam që të mos zhveshët KPF-ja. “Në KPF nuk mund të zgjidhen çështjet e këtij problemi. Kërkesa të adresohet në drejtorinë përkatëse dhe të na sjellët për shqyrtim”, theksoi prof. Desku.

**Fadil Gashi**, tha se ka qenë mirë që të na sqarohet që në këtë seancë prezanton përfaqësuesi i lagjes. “Ta kemi parasysh, është jashtë kompetencave tona. Është diçka që duhet të trajtohet në mënyrë serioze. Të mos shkelim, ku nuk mund të bëjmë zgjidhje”, tha anëtari Gashi.

**Skënder Merturi**, tha se a mund të kërkojmë nga drejtoria gjegjëse të sjellë të shqyrtuar dhe të sqaruar kërkesën. “Jam për ta zgjedhë çështjen e këtij problemi”, ka konstatuar anëtari Merturi.

**Haxhi Ibishi**, tha se jemi në dakord me këtë propozimin

**Ramush Agushi**, tha që kërkesa le të shoje në drejtorinë gjegjëse dhe nga drejtoria le të në vije me informacione të nevojshme dhe të sakta.

Kryesuesi Ibishi vuri në miratimin rekomandimin që kërkesa të adresohet në drejtorinë gjegjëse dhe pastaj le të vije për shqyrtim.

**Me vota unanime u miratua rekomandimi që kërkesa t’i drejtohet drejtorisë përkatëse dhe me të dhëna dhe sqarime nga drejtoria kërkesa mund t’i adresohet KPF-së dhe Kuvendit.**

Kërkesa e DKA-së në Klinë, për të proceduar me kërkesën e shkollës fillore “Ali Krasniqi” në Ujmir dhe këshillit të prindërve të kësaj shkolle rreth transportimit të nxënësve të fshatrave Shtaricë dhe Dobërdol.

Kryesuesi e lexoi kërkesën. Hapi Diskutimin.

**Hali Desku**, asnjëherë nuk kam qenë i prirë për të qenë lokalist, prandaj po kërkoj mirëkuptim, sepse çdo ditë jam andej dhe e di gjendjen dhe rrezikshmërinë e atyre fëmijëve të rrezikuar. “E shoh që kërkesa është në rrugë për t’u zgjidhur, sepse ka arsyeshmërinë e saj. Jam ithtar që edhe në lokalitetet tjera të zgjidhet ky problem. Nxënësit e fshatrave të Shtaricës dhe të Dobërdolit janë të rrezikuar. Në rrugën e Shtaricës, e cila ka shumë lakesa është shumë e vështirë për t’u ndërtuar trotuaret, prandaj fëmijët janë të detyruar që të ecin rrugës. Edhe fëmijët e fshatit Dobërdol janë të rrezikuar, sepse shpejtësia e veturave që frekuentojnë është e madhe. E mbështes fuqishëm këtë kërkesë dhe kërkoj që të realizohet sa më shpejt”, theksoi prof. Desku.

**Fadil Gashi**, theksoi se e para, është mirë që DKA të na sqarojë që transporti a është me ligj apo prej sa kilometrave. “E dyta, jam por duhet shqyrtuar se a është me ligj. Do të nxis edhe fshatrat tjerë për ta bërë të njëjtën kërkesë. Rrezikshmëria është për të gjitha fshatrat. Po kërkoj prej drejtorit të na sqarojë sa është kostoja dhe cilat fshatra janë në të njëjtën gjendje, në mos më keq”, është shprehur anëtari Gashi.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se kërkesat të kësaj natyre janë të arsyeshme, mirëpo është mirë që të përfitojnë të gjithë, jo në mënyrë selektive. Trajtimi le të jetë në mënyrë të unifikuar. Të mos lejohet sipas kërkesave të qytetarëve, por të jetë vlerësim i DKA-së dhe në harmoni të vlerësohen këto kërkesa”, vlerësoi prof. Shabanaj.

**Skënder Merturi**, theksoi se kërkesat janë të arsyeshme, mirëpo DKA duhet t’i shoh kriteret, po ashtu edhe kushtet e atij që i bart. “Fëmijët le të jenë të sigurt në transportimin e tyre”, tha anëtari Merturi.

**Ramush Agushi**, tha se e di që janë të caktuara kriteret e transportimit; e di që është e rregulluar në bazë të kilometrave. “Duhet të jemi të vetëdijshëm se do të pasojnë edhe kërkesat tjera. Këtu si kriter le të jetë largësia. E përkrahi kërkesën dhe të këqyrim qysh të ndihmojmë., por edhe ta kemi parasysh se çfarë do të na pasojë më tutje”, tha anëtari Agushi.

**Halil Desku**, tha se mbështeta edhe të tjerët e jo vetëm atë të lokalitetit që i takoj. “Ishim në dakord për t’i përkrahur edhe të tjerët Nxënësit të gjithë janë të barabartë. Le të

procedohet në KK dhe atje të merret vendimi. Ta inkurajojmë DKA-në në mënyrë që nga fillimi i vitit tjetër shkollor le t'u mundësohet edhe nxënësve të tjerë udhëtarë ku ka nevojë”, tha prof. Desku.

**Hajdin Morina**, iu përgjigj interesimeve të anëtarëve. “Komuna kërkon transport të sigurt. DKA ka bërë analiza, rrezikshmëria është e evidente, edhe nga trafiku, por edhe nga qentë endacakë. Kemi kërkuar që transporti të jetë i sigurt. Duhet të sillemi me të gjithë njëjtë. Ligji duhet respektuar, mirëpo kur është në pyetje rrezikimi i jetës , ligjin duhet ndryshuar”, pohoi ndër të tjera drejtori Morina.

**Ndue Shabanaj**, theksoi se dakordimi është në arsyeshmërinë e kërkesës. “Seleksionimin s’duhet bërë as drejtorja, as KPF-ja, as KK. Këtë realitet duhet pasur parasysh”, theksoi prof. Shabanaj.

**Haxhi Ibishi**, tha se Drejtorja e Arsimit të na sjell një projekt rreth rrezikshmërisë së nxënësve në shkollat tona.

**Halil Desku**, tha se e thashë që është mirë që është mirë ta inkurajojmë drejtorinë që nga 1 shtatori të jetë gjithëpërfshirja e sigurimit të transportit të nxënësve aty ku ka nevojë. “Ta procedojmë për rekomandim për në Kuvend”, tha prof. Desku.

**Fadil Gashi**, tha se të hyjnë edhe Këpuzi, edhe Bokshiqi, edhe Gllareva. “Jam që ligji të mos shkelet. “Drejtorja e Arsimit le ta bëjë një projekt dhe pastaj mund të vendosim”, theksoi Gashi.  
**Halil Desku**, tha se këtë kërkesë nuk mund ta injorojmë, sepse është me nënshkrime të qytetarëve. “Nga 1 shtatori 2017 le të bëhet një projekt dhe të procedohet”, theksoi prof. Desku.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin për një plan të përgjithshëm.

KPF rekomandon që nga DKA të bëhet një plan gjithëpërfshirës për të gjitha shkollat me të njëjtën nevojë në Komunën e dhe t’ia paraqes KPF-se dhe KK\_së për muajin prill. Rekomandimi u miratua unanimisht.

Kryesuesi falënderoi për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 11:45 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI

